

ADINGPOKS 1B EKO

Paralyerje dy-komponentëshe epokside për mbrojtje të sipërfaqeve të betonit.

Fusha e aplikimit

Lyerje epokside me ngjyrë i dedikuar për përpunim përfundimtar mbrojtës dhe dekorativ të sipërfaqeve të betonit nëpër depo, garazhe, vend-parkime, reparte prodhuese, spitale, laboratorë, mbrojtje të mbështjelljeve sekondare të tuneleve dhe ngjashëm. Lyerja krahas asaj që i kënaq kërkesat estetike për dukjen përfundimtare të nënshtresës, karakterizohet edhe me rezistencë të lartë mekanike. Materiali ka viskozitet të qëlluar për aplikim të lehtë në sipërfaqe të betonit.

Cilësi:

- Trashësi e lyerjes deri 200 μ për një shtresë;
- Adezion i shkëlqyer për nënshtresën;
- Rezistent për nga ana mekanike;
- Rezistent për nga ana kimike në acide të holluara, baza, tretje të kripërave dhe vajrave minerale;
- Mbrojtje e lartë ndaj karbonizimit të betonit;
- Jo-toksik në gjendje të lidhur;
- I pa depërtueshëm ndaj ujit;
- Rezistent për nga ana bakterologjike;
- Aplikim i lehtë dhe i thjeshtë me cilindër ose spërkatje me makinë;
- Dekorativ – mundësi për përpunim në më tepër nuanca;
- I lehtë për mirëmbajtje;

Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Përzierje pastoze me ngjyrë
Raport I përzierjes	EN ISO 2811-1	A:B=7:1
Dendësia e A komponentës	EN ISO 2811 - 1	(1,6 – 1,7) g/cm ³
Dendësia e B komponentës	EN ISO 2811 - 1	(1,0 – 1,05) g/cm ³
Kohë e përdorshmërisë (pot-life)	EN ISO 9514	4 6 h
Kohë e hapur për punë	-	30 – 45 min.
Aplikimi I shtresës së dytë në temperaturë prej 20-25° C	-	Pas 24 h
Fortësi adezive (lidhje)	EN 1542	≥ 3 Mpa
Rezistencë në ndikese të fuqishme kimike	EN 13529	Klasi I
Ngarkesë kimike	-	Pas 14 ditë
Stabilitet në temperaturat	-	- 20 deri + 70° C

Metodologjia e realizimit:

Nënshtresa duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, pa yndyrëra dhe pa pluhur, me fortësi minimale në presion prej 25Mpa. Të gjitha dëmtimet nevojitet që të sanohen me materiale përkatëse. Lëngu i çimentos që ka dalë përsipër dhe pa-pastërtitë e tjera duhet të mënjanoher me mjete mekanike, përkatësisht kimike. Nënshtresa e thatë dhe e shëndoshë nuk ka nevojë të prajmerohet. Nënshtresa e betonit të freskët (jo më e vjetër se 28 ditë) duhet të prajmerohet me Adingpoks 1PV.

Materiali përgatitet me përzjerje të komponentës A me mikser të ngadalshëm elektrik pas së cilës shtohet B komponenti dhe masa përzihet deri në homogjenizimin e plotë në maksimum 500 rrot./min. Përzjerja e ngadalshme e prodhimit është kyçe për tu shmangur depërtimi i ajrit dhe paraqitja e defekteve të lyerjes së aplikuar.

Prodhimi mund të aplikohet në mënyrë manuale me cilindër, ose me makinë me air-less spërkatje – e përshtatshme për vendosje në sipërfaqe vertikale. Për arritje të shtresës me trashësi të barazuar dhe dukje dekorative përfundimtare nevojitet që lyerja të aplikohet në dy shtresa. Shtresa e dytë vendoset pas fortësimit të shtresës së parë. Te nënshtresat që kanë shkallë të lartë të thithjes rekomandohet aplikim i tri shtresave ose prajmerim paraprak të nënshtresës me ADINGPOKS 1P dhe dy shtresa ADINGPOKS 1B EKO.

Temperatura ambientale dhe temperatura e nënshtresës duhet të jenë në kufijtë prej 5° C deri 30°C. Nëse materiali vendoset në temperatura më të ulët ose temperatura në kufij të të lejuarës, në periudhën përderisa vendoset dhe në periudhën përderisa materiali forcohet, nevojitet që të kihet kujdes në pikën e krijimit të vesës. Në kushte të tilla mund të ndodh ndryshimi i ngjyrës së lyerjes në disa pjesë të sipërfaqes, por ndryshime në cilësitë fizike dhe kimike të materialit nuk do të ketë.

Shpenzimi:

Vendosja është me furçë ose cilindër me lesh; Për një shtresë: 0,10-0,30 kg/m² - varësisht nga nënshtresa.

Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohet me Rastvoruvaç – P menjëherë pas përdorimit.

Paketimi:

Në set A + B : 24 kg
A komponenti: 21 kg
B komponenti: 3 kg

Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në hapësira të thata, në temperaturë prej 10°C deri 30°C e mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell ngrirje. Afati i përdorimit : 9 muaj.

Ngjyra standarde:

RAL 1001, RAL 1015, RAL 302, RAL 5024, RAL 6019, RAL 6021, RAL 004, RAL 7032, RAL 7035, RAL 7046, RAL 9002.



ADING ShA SHKUP

Novosellski pat (rr. 1409) nr. 11,1060 Shkup,
R. e Maqedonisë

16

2032-CPR-11.5
EN 1504-2

ADINGPOKS 1B EKO

Prodhim i dedikuar për rritje të rezistencës fizike të betonit lyerje dy-komponentëshe epokside

Fortësi adezive:	≥ 2,0 N/mm ²
Absorbim kapilar:	< 0,1 kg (m ² · h _{0,5})
Rezistencë në abrazion:	< 3000 mg
Fortësi në goditje:	Klasi II ≥ 10 Nm
Reagim në zjarr:	Euroklasi F
Substanca të rrezikshme:	Cilësia nuk është përcaktuar

Rrezik për jetën: Në rast të kontaktit incidental të prodhimit me lëkurën të mënjanoher me pëlhurë lehtë e lagur me Rastvoruvaç – P, e pas kësaj menjëherë të pastrohet me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarr: Nevojitet që të sigurohet ajrosje e hapësirave ku punohet me rërshira ose tretës.

Pastrimi dhe vendosja në depo: Mbetjet e palidhura të Adingpoks – 1B EKO pastrohen me Rastvoruvaç P. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe regullativave lokale për atë lloj të mbetjeve. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.